

VENDIM
Nr.52, datë 28.1.2005

PËR SHPËRNDARJEN ME KOEFICIENT KREDITORËVE TË SHOQËRISË “VEFA HOLDING” SHPK, NË ADMINISTRIM, TË VLERAVE FINANCIARE, TË REALIZUARA NGA SHITJA E ASETEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 1 e 3 të nenit 8 të ligjit nr.8360, datë 10.6.1998 “Për kriteret dhe mënyrën e shpërndarjes së pasurive të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 7 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërndarjen kreditorëve të shoqërisë “Vefa Holding” sh.p.k., në administrim, të vlerave financiare, sipas koeficientit të kthimit të shumave, në masën 11 për qind, të llogaritur si raport i të ardhurave, të realizuara dhe të depozituara në bankë, nga shitja e aseteve dhe shumës së detyrimit të mbetur, që shoqëria huamarrëse ka ndaj kreditorëve, ku:

a) të ardhurat financiare, të realizuara nga shitja e aseteve të shoqërisë “Vefa Holding” sh.p.k., në administrim, dhe të depozituara në bankë janë 3 800 000 000 (tre miliardë e tetëqind milionë) lekë;

b) shuma e detyrimit të mbetur, që shoqëria huamarrëse “Vefa Holding” sh.p.k., në administrim, ka ndaj kreditorëve, është 34 361 781 170 (tridhjetë e katër miliardë e treqind e gjashtëdhjetë e një milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e një mijë e njëqind e shtatëdhjetë) lekë.

2. Shpërndarja e vlerave financiare për rrethet Tiranë, Vlorë, Durrës dhe Korçë të kryhet nga Banka Kombëtare Tregtare.

Rregullat për mënyrën, kohën dhe radhën e shlyerjes së kreditorëve do të caktohen në një marrëveshje të veçantë, ndërmjet Grupit Mbikëqyrës dhe Bankës Kombëtare Tregtare.

3. Të ardhurat financiare, që do të sigurohen nga shitja e aseteve të mbetura gjendje, sipas pasqyrës që i bashkëlidhet këtij vendimi, pas fillimit të kompensimit të kreditorëve, të depozitohen në llogaritë që do të çelen pranë Bankës Kombëtare Tregtare për llogari të kreditorëve të shoqërisë “Vefa Holding” sh.p.k., në administrim dhe të përdoren në dobi të tyre, sipas kriterëve, rregullave dhe procedurave, që do të caktohen me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

4. Vlera financiare prej 3 800 000 000 (tre miliardë e tetëqind milionë) lekësh (e konvertuar), gjendje në llogaritë bankare të shoqërisë “Vefa Holding” sh.p.k., në administrim, në Raiffeisen Bank, të transferohet, brenda muajit janar 2005, në llogarinë për shlyerjen e kreditorëve, të çelur pranë Bankës Kombëtare Tregtare.

5. Shpenzimet për komisionin e shërbimit bankar, që do të kryhet pranë sporteleve të Bankës Kombëtare Tregtare, në zbatim të pikës 2 të këtij vendimi, në shumën 100 (njëqind) lekë për çdo kreditor, e cila në total arrin vlerën 7 400 000 (shtatë milionë e katërqind mijë) lekë, të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave. Kjo shumë të shtohet në planin financiar të Grupit Mbikëqyrës, zëri “Shpenzime”, në përfundim të shlyerjes së vlerave financiare kreditorëve të shoqërisë “Vefa Holding”, sh.p.k., në administrim.

6. Ngarkohen Ministria e Financave, Grupi Mbikëqyrës dhe administratorët e pavarur të shoqërisë “Vefa Holding” sh.p.k., në administrim, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

LISTA E ASETEVE TË MBETURA DHE TË PASHITURA TË SHOQËRISË HUAMARRËSE “VEFA HOLDING” SHPK, NË ADMINISTRIM

	Asete në administrim	Vendndodhja e objektit	Indeks	Numri i dokumentit hipotekor	Sipërfaqja e objektit	
					Gjithsej m ²	Ndërtime m ²
a	b	1	2	3	4	5
1.	Shoqëria “Vefa Holding” sh.p.k., në administrim					
1.1	Ndërtesë dykatëshe	Tiranë	v.006	473	460	220
1.2	Truall në fshatin Qafë	Skrapar	v.160	45	290	-
1.3	Ndërtesë e ish-fabrikës së lëkurës	Skrapar	v.156	179	1000	457
1.4	Ish-hotel Gjerbës	Skrapar	v.159	54	232	170
1.5	Objekt në Zavalinë	Elbasan	v.116	171	475	470
1.6	Magazinë e prodhimit të sallamit	Përmet	v.082	1553	542	460
1.7	Tokë bujqësore	Pukë	v.129	1410	4000	-
1.8	Depo drithi	Skrapar	v.157	58	1000	1000
1.9	Baxho “Dobrush”	Skrapar	v.161	8	112	160
1.10	Ish-pularia	Shkodër	v.133	9354	48800	10700
1.11	Lokal në Babli	Mat	v.127	5	210	210
1.12	Baxho qumështi Pobrat	Berat	v.166	177	900	300
1.13	Magazinë	Përmet	v.84	1030	183	174